

Nr: 45/2024	Nr: Protokoli: 76/2024
Për:	Seticommerc SH.P.K., me adresë në Shirokë
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet
Datë:	12.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **06.08.2024** nga Operatori Ekonomik: : **Seticommerc SH.P.K.**, me adresë në **Shirokë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Guri i Matozit Gradancë në fshatin Mushtisht - faza e parë** me Numër të prokurimit: **624-24-7894-5-1-1** Numër i brendshëm **624-24-68-511** nxjerr këtë:

### VENDIM

**REFUZOHET** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Seticommerc SH.P.K., me adresë në **Shirokë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : **Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Guri i Matozit Gradancë në fshatin Mushtisht - faza e parë** me Numër të prokurimit: **624-24-7894-5-1-1** Numër i brendshëm **624-24-68-511** kundër: (NJOLI'TIMIT PER KONTRATE TE AK), të datës **01.08.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit te lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Seticommerc SH.P.K., me adresë në Shirokë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Guri i Matozit Gradancë në fshatin Mushtisht - faza e parë** me Numër të prokurimit: 624-24-7894-5-1-1 Numër i brendshëm 624-24-68-511 Kundër (NJOFITIMIT PER KONTRATE TE AK), të datës: 01.08.2024 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 06.08.2024 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me pretendimin ankimor ndaj Kërkesa 4 ne Dosje te tenderit tek Kapaciteti teknik dhe profesional.

### **Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor**

I nderuar OE kerkesa e juaj eshte e pa arsyeshme me faktin se kerkoni eliminimin e 50% të kapacitetit Teknik per kryerjen e punimeve, ku secila makineri e kerkuar është e nevojshme për kryerjen e projektit sipas paramases.

**Kërkesa Aneksi 7 pika 4**, kjo makineri është e nevojshme për pozicionin 3.02 i cili është material shkëmbor dhe është e nevojshme një gërmim frontal me këtë lloj të makineris, makineria e sygjruar nga ju nuk i plotëson kushtet për këtë lloj të materialit, kjo i plotëson kushtet vetëm për material të shkrift (përpunuar).

**Kërkesa Aneksi 7 pika 8**, nevojitet për bartje të këtyre makinerive aneksi 7 pika 4.

**Kërkesa Aneksi 7 pika 9**, pasi që kemi të bëjme me rrugë malore dhe nuk kemi vendbanime afër rrugës, një pjesë e materialit të pos 3.02 në paramasë mund të përdoret për mbushje ky cilindër vibrues është minimum i nevojshëm për punimin e këtij materiali sipas projektit dhe paramasës.

**Kërkesa Aneksi 7 pika 9**, duke marr parasysh që projekti kalon 100% nëpër drunjë në të dya anët e rrugës dhe e tërë trasa është në zonën e parkut Mali I Sharrit atëherë një pjesë e madhe e drunjëve janë jashtë trupit të rrugës mirpo degët e tyre pengojn në realizimin e projektit, duke marr parasysh ruajtjen e drunjëve kemi parapar vetëm krasitjen e tyre përgjat trases, kjo makineri është e nevojshme për këtë lloj pozicioni.


Andaj në aneksin 7 janë kërkesa minimale për kryerjen e punimeve për këtë lloj të kategorisë së rrugës.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit



Komuna e Suharekës

